REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Numri/Broj 893, 894/20
Datë/Datum 03.12.2020
PRISHTINË · PRIŠTINA

PSH.nr.893/20
894/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenkovic – Antarë duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik "Shkëmbi-Gllarevë" SH.P.K-Klinë dhe OE N.N.SH "World Medium"-Malishevë, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i urës në rrugën nacionale N9 segmenti Pejë-Kuqishtë lokacioni Drelaj", me nr. të prok: 205-20-3973-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit", më datën: 02.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHEN**, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik "Shkëmbi-Gllarevë" SH.P.K-Klinë dhe OE N.N.SH "World Medium"-Malishevë, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i urës në rrugën nacionale N9 segmenti Pejë-Kuqishtë lokacioni Drelaj", me nr. të prok: 205-20-3973-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit".

II. **VËRTETOHET**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Ndërtimi i urës në rrugën nacionale N9 segmenti Pejë-Kuqishtë lokacioni Drelaj" , me nr. të prok: 205-20-3973-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit", ndërsa nëse edhe më tutje AK-ja ka interes për të vazhduar më këtë aktivitet të prokurimit, të njëjtin mund ta **Ritenderoj** konform dispozitave të LPP-së.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues "Shkëmbi-Gllarevë "SH.P.K-Klinë, dhe OE: N.N.SH "World Medium"-Malishevë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatorët ekonomik ankues "Shkëmbi-Gllarevë "SH.P.K-Klinë, dhe OE: N.N.SH "World Medium"-Malishevë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 02.11.2020 me nr. 893/20 ,dhe me 06.11.2020 me nr. 894/20 , kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i urës në rrugën nacionale N9 segmenti Pejë-Kuqishtë lokacioni Drelaj", me nr. të prok: 205-20-3973-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60, 62, dhe 72 të LPP-së, si dhe nenin 44.5 i RRUOPP-së, te ankesa me nr. 893/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60, 62 dhe nenin 72 të LPP-së, si dhe nenin 44.5 i RRUOPP-së, te ankesa me nr. 894/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 08.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 18.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin për OE "SHKËMBI-GLLAREVË" Sh.p.k – Klinë

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues thotë që AK e ka eliminuar me arsyetimin qe edhe pas sqarimeve nuk ka prezantuar marrëveshje me qira të pajisjeve të noterizuara në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit sipas kërkesës, ndërsa OE ankues pretendon se e ka plotësuar këtë kërkesë konform FDT-së dhe njoftimit për kontratë. Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për kontratë është:" Lista e

mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1" Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar : "Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë,DUD etj)" Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit. Pas analizës së dokumentacionit të ofruar në E prokurim, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka ofruar një marrëveshje për qira të makinerisë e cila është e lidhur në mes të: "N.P. VICTORIA INVEST INTERNATIONAL SH.P.K" si qiradhënës dhe OE "SIIKEMBI-GLLAREVË SH.P.K si qiramarrës. Në këtë marrëveshje bëhet fjalë për makinerinë (MAKIN VINÇ, DUD DOGANOR R7455), e cila përmban të dhënat si emërtimi i projektit në fjalë, data e fillimit, kohëzgjatja e marrëveshjes, nënshkrimin dhe është vulosur, ndërsa si dëshmi është ofruar DUD Doganor. Mirëpo eksperti shqyrtues vlerëson që kjo marrëveshje nuk është konform FDT-së dhe njoftimit për kontratë për faktin se në kërkesë thuhet që marrëveshjet duhet të jenë të noterizuar. Andaj duke pas parasysh kërkesën e FDT-së dhe dëshmitë e ofruar nga OE ankues, eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar për faktin se marrëveshja e ofruar nuk është e noterizuar, nuk është konform dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Përgjigje në Pretendimin për OE: N.N.SH "WORLD MEDIUM" Malishevë

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues thotë se arsyeja e eliminimit nga AK-ja është që nuk i kemi plotësuar kërkesat tek kapaciteti teknik pika 5. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike qe janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit, nuk qëndron për faktin se kemi plotësuar në tërësi kërkesat e DT-së. Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për kontratë është:" Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1" Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar : "Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë,DUD etj)" Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit. Në vijim gjeni te bashkangjitur tabelën me pajisje të kërkuar nga AK-ja,sipas Aneksit 1 të Dosjes së tenderit.

IV: PAISJET E NEVOJSHME PËR KËTË PROJEKT:"Ndërtimi i Urës në rrugën N9,lokacioni Drelaj'

Nr:	Përshkrimi i paisjes	Sasia e kërkuar	Sasia që ofron ofertuesi	Të dhënat për paisjet (viti i prodhimit,gjendja e paisjes,kamiona ,rezh.i targave ,mekanizmi,dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë huazimi).
1	Eskavator kapac. min(0.4-1.0)m^3	2		
2	Kamion kapacitet min(10-12)m3 kiper	4		
3	Ngarkues,kapac.min(1-1.5)m3	2		
4	Cilindër për kompaktimin e tamponit nën themele	1		
5	Paisjet për lakimin e armaturës	1		
6	Automjet të specializuar për bartjen e betonit të gatëshëm	1		
7	Vibrator për beton	1		
8	Çekan Pneumatik/Hidraulik	1		
9	Cisternë për karburante	1		
10	Vinç për bartjen e trajëve të Paranderë me fiqi bartëse prej së paku 30 t	1		

Në pikën 1 të kësaj kërkese është kërkuar 2 (Dy) Ekskavator me kapacitet min (0.4-1.0)m3,ndërsa OE ankues për këtë kërkesë ka paraqitur: Ekskavator Kamatsu 150 ES-6 me peshe 15000 kg me 1. 14m3 me shume se (0.4-l. O)m3; Liebher 912 LC me peshe 22000 kg me O. l 5-0.48m3 me pak se (0.4-l.O)m3; Catepilar 320 me peshe 22700 kg me 1.14-1.50 m3 me shume se (0.4-l.O)m3, Komatsu PC228 23500 kg me 0.50-1.2 m3 dhe 0.66-l.57m3 me shume se (0.4-1.0)m3, Komatsu 18000 kg. me l.14m3 me shume se (0.4-l.O)m3; Liebher A310B me 0.15-0.44m3 me pak se (0.4-l.O)m3; Lidhur me ketë pretendim eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka paraqitur një gamë të madhe të makinerisë për të cilat ka ofruar edhe dëshmi DUD Doganor, mirëpo makinerinë e ofruar nga OE ankues nuk është në përputhje me kërkesën e FDT-së, ku është kërkuar kapaciteti i ekskavatorëve (0.4-1.0)m3,ekskavatorët e ofruar disa janë më shumë se kërkesa e disa janë më pak se kërkesa (0.4-1.0)m3. Andaj pas analizës së dokumentacionit të ofruar në E-prokurim, pas krahasimit të makinerisë së ofruar dhe klikimeve në Internet për këto tipe të Ekskavatorëve, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE ankues nuk qëndron për faktin se makineria e ofruar nuk është konformë kërkesës së FDT-së dhe Njoftimit për kontratë.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2
Lidhur me arsyen e eliminimit në pikën 2 të këtyre pajisjeve është kërkuar Kamion me kapacitet min (10-12)m3 kiper, sasia 4 (katër),ndërsa AK thotë se OE ankues ka ofruar kamion kiper: 05-410-CQ, 07-359-BQ, 07-461-CT. Ne Librezat e prezantuara nuk figuron kapaciteti i kamionëve dhe pas kërkesës për sqarim OE ka prezantuar vetëm foto si dëshmi, ku me ane te fotove nuk plotësohet kërkesa për sqarim. Në vijim gjeni të bashkangjitura listat me kamionë nga të dy anëtarët e konzorciumit:

9	Kamion Kiper	MERCEDES	2644 K 6x4	LIBREZË
10	Kamion Kiper	MERCEDES	2626 AK 6x6	LIBREZË
11	Kamion Kiper + Kran	IVECO	MAGIRUS	LIBREZË
12	Kamion	MAN 26403	HD32A	FATURË
13	Rimorkio, Llobodicë	MYLLER 730		LIBREZË
14	Rimorkio, Llobodicë	STEYR	CONDOR	LIBREZË

Kamionat			
1	Kamion	Mercedes Actros	05-410-CQ
2	Kamion	Mercedes Actros	05-739-CS
3	Kamion	Mercedes Actros	05-941-CC
4	Kamion	Mercedes	05-358-EH
5	Kamion	Mercedes Actros	05-935-DH
6	Kamion	Mercedes Actros	05-384-DM
7	Kamion	Mercedes Actros	05-684-DH
8	Kamion	Mercedes Actros	05-497-EA
9	Rimorko	Kogel	05-405-TA
10	Kamion	Mercedes Benz	05-223-EL
11	Kamion	Steyr	05-162-CR
12	Kamion	Scania	05-732-AU
13	Kamion	MAN TGS 31.360	05-154-EG
14	Kamion	MAN TGS 41.480	05-187-EG
15	Kamion Cisternë AutoBode	Mercedes Benz 2226	05-858-EE
16	Koke Tetheqëse	Mercedes Actros 1846	05-247-EL
17	Rimorkio	Schmitz	05-840-XB
18	Rimorkio per bartje te paisjeve	Rimorkio	05-498-TA

AK-ja ka kërkuar sqarime nga OE ankues për kamionët, ndërsa OE ankues ka dhënë përgjigjen dhe ka paraqitur fotografi për këto tre makineri (05-410-CQ, 07-359-BQ, 07-461-CT),ndërsa kërkesë ka qenë katër kamionë. Pas analizës së dokumentacionit të ofruar për kamionët nga OE ankues për plotësimin e pikës 2 të Aneksit 1 të DT-së, ku është kërkuar "Kamion kapacitet min (10-12)m3 kiper sasia 4". Eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues edhe pse ka prezantuar makineri të shumët për këtë projekt, mirëpo kamionët e prezantuar nga OE ankues nuk janë konformë Aneksit 1 të FDT-së dhe Njoftimit për kontratë, andaj ky pretendim i OE ankues është i pa qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

Operatori ekonomik ankues është eliminuar edhe për pikën 3 të Aneksit 1 të FDT-së, është kërkuar Ngarkues, kapac. min(1-1.5)m3 sasia 2 (Dy).OE ankues pretendon që ka plotësuar në tërësi kërkesën e DT-së ndërsa AK thotë: Është kërkuar pika 3 Ngarkues, kapac. Min (l-1.5)m3, ndërsa ju keni prezantuar: Ngarkues Thomas TZP me peshe 3600 kg, nuk ka dërguar informacione. Zettelmeyer 180l me peshë 12000 kg, me 2.0m3 me shume se (1-1.5)m3 Liehber L580 me peshe 30000kg, me 5 m3 me shume se (1-1.5)m3 Cat me peshe l 4000kg, ne sqarime keni prezantuar Atlas A R95 i cili nuk është ne ofertë. O&K me peshe 1OOOOkg, nuk ka dërguar informacione.

Pas analizës së dokumentacionit të ofruar nga OE ankues, lidhur me makinerinë ngarkuese, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka paraqitur informacione shtesë për disa ngarkues të kërkuar nga AK-ja, për ngarkuesin Thomson TYP 245 për të cilin AK thotë se nuk ka dhënë informacione OE ,pajisja e ofruar posedon dëshmi dokumentare DUD Doganor. Për verifikim sa më të mire të pajisjes eksperti shqyrtues ka bërë kërkim në internet dhe pajisja e ofruar nuk është konform FDT-së. Më poshtë gjeni të bashkangjitur të dhënat për ngarkuesin.

Technical specs - T 245 HDk Thomas

Notice. Every data listed is verified by LECTURA Specs team experts. However, incomplete data and mistakes might occur. Contact our team with any change suggestion.

Weight	3.63 t	Rated operating capacity	1089 kg
Standard tyres	12x16.5	Bucket capacity	0.65 m³
Transport length	3.68 m	Transport width	1.85 m
Transport height	2.12 m	Travel speed	10 km/h
Engine manuf.	Kubota	Engine type	V3300T
Engine power	65 kW	Track width	###
Bucket width	###	Driver protection	###

Sa i përket pajisjes të ofruar nga OE ankues Atlas AR 95 për të cilin AK thotë se nuk është në ofertë, sqarojmë se kjo makineri është ofruar nga anëtari i konzorciumit OE "N.N Ndërtimi", po ashtu edhe për këtë pajisje është kërkuar në internet dhe pajisja e ofruar përmban këto të dhëna. Shih në vijim tabelën.

Technical specs - AR 95 E Super Atlas

Notice: Every data listed is verified by LECTURA Specs team experts. However, incomplete data and mistakes might occur. Contact our team with any change suggestion.

Weight	8.2 t	Standard tyres	15.5-25 EM 20
Bucket width	2.3 m	Bucket capacity	1.6 m³
Bucket capacity min.	1.4 m³	Bucket capacity max.	1.6 m³
Steering mode	KL	Transport length	6.23 m
Transport width	2.18 m	Transport height	2.93 m
Travel speed	20 km/h	Max. discharge height	2.84 m
Turning radius outside	4.61 m	Lifting force	82 kN
Engine manuf.	Deutz	Engine type	TCD4.1 L04
Engine power	95 kW	Displacement	4.004 l

Duke pas parasysh kërkesën sipas Aneksit 1 të FDT-së, ku është kërkuar *Ngarkues*, kapac. min(1-1.5)m3 sasia 2 *(Dy)*,eksperti shqyrtues vlerëson se kjo pajisje nuk është konform DT-së për faktin se kapaciteti i pajisjes është min 1.4 m3 – 1.6m3 dhe nuk e plotëson kërkesën e FDT-së. Për pajisjen O&K MH 210 me peshë 1OOOOkg,për të cilën AK thotë se nuk ka dërguar informacione. Për këtë pajisje OE ankues si dëshmi dokumentare ka ofruar DUD Doganor, emërtimi i makinerisë në DUD Doganor është Ngarkues

me lopatë. Gjatë kërkimit në internet rezulton t'i ketë këto të dhëna. Shih më poshtë tabelën gjatë kërkimit në internet.

Technical specs - MH 2.10 O&K

Notice: Every data listed is verified by LECTURA Specs team experts. However, incomplete data and mistakes might occur. Contact our team with any change suggestion.

Weight	10.6 t	Standard tyres	8.25-20
Bucket capacity	0,33 m³	Engine manuf.	Perkins
Engine type	1004.4	Engine power	54 kW
Bucket capacity min.	###	Bucket capacity max.	###

Sa u përket Ngarkuesve tjerë për të cilët është eliminuar OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se edhe pas sqarimeve te Ofruara nga OE ankues për AK-në dhe pas analizës së dokumentacionit të ofruar, këta ngarkues tejkalojnë kërkesën e Aneksit 1 të FDT-së ku thuhet:"Ngarkues,kapac .min(1-1.5)m3 sasia 2". Andaj pas sqarimeve të dhëna më lartë për pikën 3 të Aneksit të DT-së, rezulton se pajisjet e ofruara nuk janë konform Kërkesës së FDT-së dhe Njoftimit për kontratë. Rrjedhimisht ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE "SHKËMBI-GLLAREVË" Sh.p.k – Klinë & OE N.N.SH "WORLD MEDIUM" Malishevë të aprovohen pjesërisht si të bazuara, dhe të vërtetohet njoftimi i AK-së për anulimin e aktivitetit. Më tej rekomandohet që nëse AK edhe më tutje ka interes, atëherë mund ta inicioj aktivitetin përsëri.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 18.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, nuk ka kthyer përgjigje.

Operatori Ekonomik: "Shkëmbi-Gllarevë"SH.P.K-Klinë, me datë 23.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

PËRGJIGJE NË EKSPERTIZËN Nr. 893/20 TË DT. 18.11.2020

Ne konfirmojmë pranimin e ekspertizës Nr. 893/20 të dt. 18.11.2020 dhe ju informojmë se **NUK** pajtohem me konstatimin e ekspertit shqyrtues. Sa i përket konstatimit të ekspertit shqyrtues, ju sqarojmë se nuk pajtohemi, sepse ne e kemi ofruar e kemi cekur shumë qartë se ne e kemi plotësuar kërkesën e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë sepse i kemi prezantuar marrëveshjet origjinale të nënshkruara nga marrësi dhe qiradhënësi për pajisjet me qira, të cilat janë konform kërkesës në dosjen e tenderit. Eksperti shqyrtues nuk i ka marrë fare parasysh dëshmitë e prezantuara nga ne mirëpo vetëm e ka mbështetur

njoftimin mbi vendimin e AK-së, duke mos i analizuar fare marrëveshjet e prezantuara nga ne, të cilat shihet qartë se janë origjinale ashtu siç edhe e kemi cekur. (Ne sa për korrektësi po ju bashkëngjisim edhe një herë marrëveshjet origjinale të prezantuara nga ana jonë). Duke u bazuar në ankesën që e kemi parashtruar, në ekspertizën e ekspertit shqyrtues dhe në të gjitha faktet tona, kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovohet ankesa jonë si e bazuar, dhe të konfirmohet përgjegjshmëria e jonë dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Operatori Ekonomik: N.N.SH "World Medium "-Malishevë, me datë 19.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

PËRGJIGJE NË EKSPERTIZËN Nr.894/20 TË DT. 18.11.2020, Ne konfirmojmë pranimin e ekspertizës Nr.894/20 të dt. 18.11.2020 dhe ju informojmë se NUK pajtohem me konstatimet e ekspertit shqyrtues. Sa i përket konstatimeve të ekspertit shqyrtues, ju sqarojmë se nuk pajtohemi, sepse ne i kemi ofruar dëshmitë konkrete të cilat janë në përputhje të plotë me kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Mirëpo është për tu habitur se si eksperti shqyrtues ka dhënë konstatime të tilla duke thënë se ka hulumtuar në internet dhe i ka krahasuar me dokumentacionin në e-prokurim. Konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të pa bazuara dhe njëkohësisht vetëm mbështetje e vendimit të AK-së, pasi që nëse do ta analizonte në tërësi dokumentacionin e prezantuar nga ana e jonë, atëherë shumë lehtë do ti vërtetonte pretendimet tona ankimore. Nëse eksperti shqyrtues i ka analizuar në tërësi të gjithë dokumentacionet e konzorciumit tonë, atëherë do të jepte konstatime të qarta në lidhje me pretendimet tona ankimore. Mirëpo që një veprim i tillë nuk është bërë nga ana e ekspertit shqyrtues pasi që shihet qartë se eksperti shqyrtues ka dhënë konstatime përafërsisht të njëjta sikurse AK-ja. Duke u bazuar në ankesën që e kemi parashtruar, në ekspertizën e ekspertit shqyrtuese dhe në të gjitha faktet tona, kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovohet ankesa jonë si e bazuar, dhe të konfirmohet përgjegjshmëria e jonë dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "SHKËMBI-GLLAREVË" Sh.p.k – Klinë, se AK e ka eliminuar me arsyetimin qe edhe pas sqarimeve nuk ka prezantuar marrëveshje me qira të pajisjeve të noterizuara në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit sipas kërkesës, ndërsa OE ankues pretendon se e ka plotësuar këtë kërkesë konform FDT-së dhe njoftimit për kontratë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është:" Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1" Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar : "Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë,DUD etj)" Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar në E-prokurim, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues ka ofruar një marrëveshje për qira të makinerisë e cila është e lidhur në mes të: "N.P. VICTORIA INVEST INTERNATIONAL SH.P.K" si qiradhënës dhe OE "SHKEMBI-GLLAREVË SH.P.K si qiramarrës. Në këtë marrëveshje bëhet fjalë për makinerinë (MAKIN VINÇ, DUD DOGANOR R7455), e cila përmban të dhënat si emërtimi i projektit në fjalë, data e fillimit, kohëzgjatja e marrëveshjes, nënshkrimin dhe është vulosur, ndërsa si dëshmi është ofruar DUD Doganor. Mirëpo, kjo marrëveshje nuk është konform FDT-së dhe njoftimit për kontratë për faktin se në kërkesë thuhet që marrëveshjet duhet të jenë të noterizuara. Andaj, duke pas parasysh kërkesën e FDT-së dhe dëshmitë e ofruar nga OE ankues, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar për faktin se marrëveshja e ofruar nuk është e noterizuar, si dhe nuk është konform dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Sa i përket pretendimit të OE ankues N.N.SH "WORLD MEDIUM" Malishevë, se arsyeja e eliminimit nga AK-ja është që nuk i kemi plotësuar kërkesat tek kapaciteti teknik pika 5. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike qe janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit, nuk qëndron për faktin se kemi plotësuar në tërësi kërkesat e dosje së tenderit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është:" Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1" Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar : "Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë,DUD etj)" Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij

projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Në vijim është paraqitur tabela me pajisje të kërkuar nga AK-ja, sipas Aneksit 1 të dosjes së tenderit.

IV: PAISJET E NEVOJSHME PËR KËTË PROJEKT:"Ndërtimi i Urës në rrugën N9,lokacioni Drelaj'

Nr:	Përshkrimi i paisjes	Sasia e kërkuar	Sasia që ofron ofertuesi	Të dhënat për paisjet (viti i prodhimit,gjendja e paisjes,kamiona ,rezh.i targave ,mekanizmi,dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë huazimi).
1	Eskavator,kapac. min(0.4-1.0)m^3	2		
2	Kamion kapacitet min(10-12)m3 kiper	4		
3	Ngarkues,kapac.min(1-1.5)m3	2		
4	Cilindër për kompaktimin e tamponit nën themele	1		
5	Paisjet për lakimin e armaturës	1		
6	Automjet të specializuar për bartjen e betonit të gatëshëm	1		
7	Vibrator për beton	1		
8	Çekan Pneumatik/Hidraulik	1		
9	Cisternë për karburante	1		
10	Vinç për bartjen e trajëve të Paranderë me fuqi bartëse prej së paku 30 t	1		

Në pikën 1 të kësaj kërkese është kërkuar 2 (Dy) Ekskavator me kapacitet min (0.4-1.0)m3, ndërsa OE ankues për këtë kërkesë ka paraqitur: Ekskavator Kamatsu 150 ES-6 me peshe 15000 kg me 1. 14m3 me shume se (0.4-l. O)m3; Liebher 912 LC me peshe 22000 kg me O. 1 5-0.48m3 me pak se (0.4-l.O)m3; Catepilar 320 me peshe 22700 kg me 1.14-1.50 m3 me shume se (0.4-l.O)m3, Komatsu PC228 23500 kg me 0.50-1.2 m3 dhe 0.66-l.57m3 me shume se (0.4-1.0)m3, Komatsu 18000 kg. me l.14m3 me shume se (0.4-l.O)m3; Liebher A310B me 0.15-0.44m3 me pak se (0.4-l.O)m3;

Lidhur me ketë pretendim, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues ka paraqitur një gamë të madhe të makinerisë për të cilat ka ofruar edhe dëshmi DUD Doganor, mirëpo makinerinë e ofruar nga OE ankues nuk është në përputhje me kërkesën e FDT-së, ku është kërkuar kapaciteti i ekskavatorëve (0.4-1.0)m3,ekskavatorët e ofruar disa janë më shumë se kërkesa e disa janë më pak se kërkesa (0.4-1.0)m3. Andaj, pas analizës së dokumentacionit të ofruar në E-prokurim, pas krahasimit të makinerisë së ofruar dhe klikimeve në Internet për këto tipe të Ekskavatorëve, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE ankues nuk qëndron për faktin se makineria e ofruar nuk është konform kërkesës së FDT-së dhe Njoftimit për kontratë.

Lidhur me arsyen e eliminimit në pikën 2 për OE N.N.SH "WORLD MEDIUM" Malishevë të këtyre pajisjeve është kërkuar Kamion me kapacitet min (10-12)m3 kiper, sasia 4 (katër), ndërsa AK thotë se

OE ankues ka ofruar kamion kiper: 05-410-CQ, 07-359-BQ, 07-461-CT. Ne Librezat e prezantuara nuk figuron kapaciteti i kamionëve dhe pas kërkesës për sqarim OE ka prezantuar vetëm foto si dëshmi, ku me ane te fotove nuk plotësohet kërkesa për sqarim. Në vijim është paraqitur lista me kamionë nga të dy anëtarët e konzorciumit:

9	Kamion Kiper	MERCEDES	2644 K 6x4	LIBREZË
10	Kamion Kiper	MERCEDES	2626 AK 6x6	LIBREZË
11	Kamion Kiper + Kran	IVECO	MAGIRUS	LIBREZË
12	Kamion	MAN 26403	HD32A	FATURË
13	Rimorkio, Llobodicë	MYLLER 730		LIBREZË
14	Rimorkio, Llobodicë	STEYR	CONDOR	LIBREZË

Kamionat			
1	Kamion	Mercedes Actros	05-410-CQ
2	Kamion	Mercedes Actros	05-739-CS
3	Kamion	Mercedes Actros	05-941-CC
4	Kamion	Mercedes	05-358-EH
5	Kamion	Mercedes Actros	05-935-DH
6	Kamion	Mercedes Actros	05-384-DM
7	Kamion	Mercedes Actros	05-684-DH
8	Kamion	Mercedes Actros	05-497-EA
9	Rimorkio	Kogel	05-405-TA
10	Kamion	Mercedes Benz	05-223-EL
11	Kamion	Steyr	05-162-CR
12	Kamion	Scania	05-732-AU
13	Kamion	MAN TGS 31.380	05-154-EG
14	Kamion	MAN TGS 41.480	05-187-EG
15	Kamion Cisternë AutoBode	Mercedes Benz 2226	05-858-EE
16	Koke Tetheqëse	Mercedes Actros 1846	05-247-EL
17	Rimorkio	Schmitz	05-840-XB
18	Rimorkio per bartje te paisjeve	Rimorkio	05-498-TA

AK-ja ka kërkuar sqarime nga OE ankues për kamionët, ndërsa OE ankues ka dhënë përgjigjen dhe ka paraqitur fotografi për këto tre makineri (05-410-CQ, 07-359-BQ, 07-461-CT),ndërsa kërkesë ka qenë katër kamionë. Pas analizës së dokumentacionit të ofruar për kamionët nga OE ankues për plotësimin e pikës 2 të Aneksit 1 të DT-së, ku është kërkuar "Kamion kapacitet min (10-12)m3 kiper sasia 4".

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se OE ankues edhe pse ka prezantuar makineri të shumët për këtë projekt, mirëpo kamionët e prezantuar nga OE ankues nuk janë konform Aneksit 1 të FDT-së dhe Njoftimit për kontratë, andaj ky pretendim i OE ankues është i pa qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues N.N.SH "WORLD MEDIUM" Malishevë, se është eliminuar edhe për pikën 3 të Aneksit 1 të FDT-së, është kërkuar Ngarkues, kapac. min(1-1.5)m3 sasia 2 (Dy).OE ankues pretendon që ka plotësuar në tërësi kërkesën e DT-së ndërsa AK thotë: Është kërkuar pika 3 Ngarkues, kapac. Min (l-1.5)m3, ndërsa ju keni prezantuar: Ngarkues Thomas TZP me peshe 3600 kg,

nuk ka dërguar informacione. Zettelmeyer l80l me peshë 12000 kg, me 2.0m3 me shume se (1-1.5)m3 Liehber L580 me peshe 30000kg, me 5 m3 me shume se (1-1.5)m3 Cat me peshe l 4000kg, ne sqarime keni prezantuar Atlas A R95 i cili nuk është ne ofertë. O&K me peshe 1OOOOkg, nuk ka dërguar informacione.

Pas analizës së dokumentacionit të ofruar nga OE ankues, lidhur me makinerinë ngarkuese, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues ka paraqitur informacione shtesë për disa ngarkues të kërkuar nga AK-ja, për ngarkuesin Thomson TYP 245 për të cilin AK thotë se nuk ka dhënë informacione OE, pajisja e ofruar posedon dëshmi dokumentare DUD Doganor. Për verifikim sa më të mire të pajisjes, Paneli Shqyrtues sqaron se eksperti shqyrtues ka bërë kërkim në internet dhe pajisja e ofruar nuk është konform FDT-së, ku të dhënat teknike të kësaj pajisje janë bashkangjitur në raportin e ekspertit shqyrtues.

Sa i përket pajisjes të ofruar nga OE ankues Atlas AR 95 për të cilin AK thotë se nuk është në ofertë, sqarojmë se kjo makineri është ofruar nga anëtari i konzorciumit OE "N.N Ndërtimi", po ashtu edhe për këtë pajisje është kërkuar në internet dhe pajisja e ofruar përmban të dhënat sikurse në raportin e ekspertit shqyrtues

Duke pas parasysh kërkesën sipas Aneksit 1 të FDT-së, ku është kërkuar *Ngarkues*, kapac. min(1-1.5)m3 sasia 2 *(Dy)*, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se kjo pajisje nuk është konform dosjes së tenderit për faktin se kapaciteti i pajisjes është min 1.4 m3 – 1.6m3 dhe nuk e plotëson kërkesën e FDT-së. Për pajisjen O&K MH 210 me peshë 1OOOOkg, për të cilën AK thotë se nuk ka dërguar informacione. Për këtë pajisje OE ankues si dëshmi dokumentare ka ofruar DUD Doganor, emërtimi i makinerisë në DUD Doganor është Ngarkues me lopatë. Gjatë kërkimit në internet, rezulton t'i ketë këto të dhëna. Shih më poshtë tabelën gjatë kërkimit në internet.

Technical specs - MH 2.10 O&K

Notice: Every data listed is verified by LECTURA Specs team experts. However, incomplete data and mistakes might occur. Contact our team with any change suggestion.

Weight	10.6 t	Standard tyres	8.25-20
Bucket capacity	0,33 m³	Engine manuf.	Perkins
Engine type	1004.4	Engine power	54 kW
Bucket capacity min.	###	Bucket capacity max.	###

Sa u përket Ngarkuesve tjerë për të cilët është eliminuar OE ankues, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se edhe pas sqarimeve te Ofruara nga OE ankues për AK-në dhe pas analizës së dokumentacionit të ofruar, këta ngarkues tejkalojnë kërkesën e Aneksit 1 të FDT-së ku thuhet: "Ngarkues,kapac .min(1-1.5)m3 sasia 2". Andaj pas sqarimeve të dhëna më lartë për pikën 3 të Aneksit të DT-së, rezulton se pajisjet e ofruara nuk janë konform Kërkesës së FDT-së dhe Njoftimit për kontratë. Rrjedhimisht ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit në harmoni me nenin 62 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit";

1x1 OE "Shkëmbi-Gllarevë"- SH.P.K.-Klinë;

1x1 OE N.N.SH "World Medium"-Malishevë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.